



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.720/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit A.Zh. “Agro” shpk nga fshati Sfeqël Komuna e Podujevës, kundër të paditurit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje administrative K.A.nr.319/22 i datës 24.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet si e bazuar Ankesa e paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje administrative KA.nr.319/22 i datës 24.01.2024, PRISHET, dhe Lënda i kthehet të njëjtës gjykatë, në rivendosje dhe rigjykim

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e ankimuar të Dhomës së shkallës së parë, është vendosur si në vijim: I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.Zh. “Agro” shpk nga fshati Sfeqël Komuna e Podujevës, kundër të paditurit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë me seli në Prishtinë, II. Anulohet vendimi me nr.protokoli 450 datës 03.08.2020 i nxjerr nga e paditura MBPZHR-Agjencia e Zhvillimit Rural si i pabazuar, ti bëhet njohja e të drejtës si përfitues i projektit Masa 101 investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore 2019, nën masa 101.2.1 Depo me mekanizëm për ruajtjen e pemëve dhe perimeve nga MBPZHR-AZHB, III. Detyrohet e paditura që paditësit t,ia kompensoj pagesat për projektin nga Masa 101 Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore 2019, nën masa 101.2.1 Depo me mekanizëm për ruajtjen e pemëve dhe perimeve në shumë prej 60% të vlerës totale të pranueshme të projektit financiar në vlerë prej 59,280,00€ sipas kontratës 52/2019 e lidhur me datë 01.11.2019 dhe aneks kontratës nr.09/2020 datës 03.02.2020, IV. Ky aktgjykim e zëvendëson aktin e anuluar, V. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar përfaqësuesja e autorizuar e paditues, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës, aplikimit të gabuar të ligjit material dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit, të ndryshohet aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar në drejtim të thënieve në ankes, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, gjen se:

Ankesa e paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë me seli në Prishtinë, me vendimin përfundimtar të nxjerr në procedurën administrative, nr.protokoli 4150 të datës 03.08.2020, ka refuzuar ankesën e paditësit, Masa 101, nënmasa 101.2.1 depo per ruajtjen e perimeve dhe pemëve, si e pabazuar.

Kundër këtij aktvendimi paditësi A.Zh. pronar i “Agro” shpk nga fshati Sfeqël Komuna e Podujevës, ka hapur konflikt administrativ me padi në gjykatë ndaj të paditues Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë me seli në Prishtinë, respektivisht ka kundërshtuar aktin administrativ përfundimtar të paditurit.

Dhoma e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, dhe administrimit të provave relevante, si në procesverbalin e seancës për shqyrtim kryesor të datës 12.01.2024, në praninë e të autorizuarit të palës paditëse, e në mungesë të përfaqësueses së palës së paditur, me aktgjykimin e ankimuar, e Aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar sepse e paditura përkundër konstatimit nga raporti i kontrollit të parë në teren të realizuar me datën 16.10.2019, e paditura lidh kontrate me paditësin dhe aneks kontratën nr.09/2020 dt.03.02.2020. Ndërsa pas përfundimit të investimeve, pasi paditësi ka bërë kërkesë pran të paditurës për ekzekutimin e pagesës, e paditura pas dalës për të dytën herë me datën 02.04.2019 në vendin e investimit dhe me konstatime të njëjta sa i përket objektit/depos se demoluar merr vendimin e kundërshtuar nr.4150 dt.03.08.2020 me të cilin refuzohet ankesa e paditësit. Gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar në kundërshtim me rregullat e procedurës neni 29 i UA 05/2018 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural pika 12, dhe sipas nenit 32 par.6 dhe 7 të njëjtit Udhëzim. Në rastin konkret e paditura AZHB nuk i ka marrë parasysh konstatimet nga raporti i kontrollës së parë dt.16.10.2019 ku është konstatuar se objekti/depoja është demoluar, ndërsa të njëjtin konstatim e ka marrë për bazë me rastin e refuzimit të kërkesës për pages të shumës së alokuar për investim. Prandaj gjykata vlerëson se nuk kemi të bëjmë me mospërmbushje të kushteve të kontratës për financim por kemi të bëjmë me shkelje të

procedurave nga e paditura të përcaktuar me Udhëzimin administrativ për masat dhe kriteret e përkrahjes së Zhvillimit Rural, sepse e paditura nuk ka bërë vlerësimin e duhur para marrjes së detyrimeve kontraktuale dhe ka vlerësuar se aplikuesi i plotëson kriteret për fillimin e investimeve. Dhe ka marrë vendimin e kundërshtuar, ka nënshkruar kontratën e cila ka prodhuar pasojat juridike dhe paditësi ka vazhduar investimet duke u bazuar në kontratën e dt.01.11.2019. Prandaj vendimi i paditurës është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe i përfshirë ëme zbatim të gabuar të ligjit material, i kundërligjshëm dhe duhet të anulohet

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes duke ekzaminuar aktgjykimin e ankimuar, shkresat e lëndës edhe sipas pretendimeve ankimore të palës së paditur, gjen se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) dhe neni 183 i LPK-së, i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, se është juridikisht i pa qartë kundërthënës me vet vetën dhe arsyetimin e tij, po ashtu jo i plotë lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike.

Kolegji vlerësoi, se aktgjykimi i ankimuar është i mangët në përmbledhjen e fakteve vendimtare sipas gjendjes faktike të çështjes, dhe zbatimit të dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2018 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për vitin 2018. Nga shkresat e lëndës vërtetohet se paditësi ka aplikuar tek e paditura në përkrahjen e projektit për mbështetje financiare nënmasën 101.2.1 renovim i depos për ruajtjen e pemëve dhe perimeve.

Legjislacioni në fuqi respektivisht dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 05/2018 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për vitin 2018, janë të detyrueshme për AZHB, fermerët dhe përfituesit nga Masat e zhvillimit Rural. Kolegji nga ky akt nenligjor i zbatueshëm, gjen se e paditura ka autorizime ligjore në vlerësimin dhe miratimin e aplikacioneve të projekteve, ashtu që pas kontrollave në terren për të vërtetuar se janë plotsuar kriteret për fillimin e investimeve sipas planit të biznesit të aprovuar, e paditura informon aplikuesit për perzgjedhjen ose refuzimin e projektit të tyre. Në rastin konkret e paditura me vendimin nr.3167/29.05.2020 ka refuzuar përkrahjen e projektit të paditësit me arsyetimin se bazuar në raportin e II të inspektorve nga terreni dt.02.02.2020 fermeri-paditësi ka bërë demolimin e objektit ekzistues dhe ka bërë ndërtimin e ri të depos, përderisa bazuar në planin e biznesit të aprovuar, fermeri-paditësi është përfitues për renovimin e depos ekzistuese.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka marrë për bazë kryesisht raportin e kontrollit të parë në terren dt.16.10.2019, në bazë të cilit raport edhe është lidhur kontrata mes dy palëve me datë 01.11.2019 për Financimin e Projekteve Investuese të Zhvillimit Rural nr.52/2019, duke mos vlerësuar faktet vendimtare në këtë rast se paditësi iu ka përmbajtur kushteve për përkrahje të projektit nën masën 101.2.1 si përfitues në renovimin e depos ekzistuese për ruajtje të pemëve dhe perimeve.

Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, vlersoi gjithashtu se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë për bazë as autorizimet ligjore të paditues nga neni 32 pika 6 e U.A. 05/2018 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rura, që parasheh obligimin e të paditues që pas kërkesës për pagesë, të bëjë edhe kontrollin e dytë për tu siguruar se investimi është bërë sipas projektit të aprovuar nga biznesi-paditësi. Kolegji vlersoi se nënshkrimi i kontratës nga e paditura, nuk paraqet vlersim përfundimtar në miratimin e projektit të aplikuar në këtë rast nga paditësi, sepse ligjvënsi ka përcaktuar që për tu siguruar investimi i bërë nga aplikuesi-paditësi, duhet bërë edhe kontrolli i dytë në terren pas kërkesës për pagesë.

Meqë nuk kemi një vërtetim të plotë të gjendjes faktike nga dhoma e shkallës së parë, duke mos vlersuar fare çështjen kryesore se paditësi si përfitues i projektit masa 101 Sektori, Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve, iu ka përmbajtur kushteve të projektit të aplikuar nga vet paditësi, për renovimin e depon ekzistuese, apo kemi të bëjmë me një gjendje tjetër faktike sikurse ka konstatuar e paditura me vlersimin e dytë përfundimtar dt.02.04.2020 se paditësi nuk ka respektuar kushtet e kontratës për financim të projektit, duke bërë një ndërtim të ri të depon. Kolegji vleron se në rastet e ekzistimit të kontradiktave të tilla të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative, dhe në procedure të konfliktit administrativ, dhoma e shkallës së parë ka mund të zbatohet edhe nenin 43 par.2 të LKA-së.

Shkeljet e tilla respektivisht paqartësitë dhe kontradiktat si në arsyetimin e aktgjyimit të atakuar përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave ligjore, që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjyimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktgjykimi i atakuar doemos është dashur të priset.

Në riprocedurë, Dhomat e Shkallës së parë, me rastin e rivendosjes dhe rigjyimit të kësaj çështje, të shqyrtoj në baza ligjore çështjen e vlersimit të përkrahjes së projektit të paditësit për vitin 2019 nën masën 101.2.1, ashtu që të vërtetohet drejt gjendja faktike se janë plotsuar kriteret në investimin e planit të miratuar si përfitues për renovimin e depon ekzistuese për ruajtjen e pemëve dhe perimeve, dhe varsisht nga sigurimi i gjendjes së vërtetuar faktike dhe bazës ligjore të merr aktgjykim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga arsyet e lartë cekura aktgjykimi i ankimuar, priset dhe lënda i kthehet Dhomës së shkallës së parë në rigjykim.

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 dhe nenit 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.720/24 datë 29.05.2024

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha